UDHËTIM NË HISTORI ME RININË

Osman Nuri TOPBASH

TITULLI ORIGJINAL
GENÇLERLE TARİH YOLCULUĞU

PËRKTHEU
Ilir Hoxha

REDAKTOI
Zija Vukaj

FAQOSJA
Bledar Xama

BOTIMI I
Prill 2021, Shkodër

PROGRESI BOTIME
Sheshi “2 Prilli”, Rr: Studenti
Shkodër, Shqipëri
Mob: +355 67 340 6182

Përmbajtja

Përmbajtja 3
Një ëndërr plot përgëzime 4
Ëndërra e një fëmije 7
Tarih baba 9
Vizitë tek Osman Gazi 11
Vizitë tek Murat Hani 18
Vizita tek Fatih Sulltani 22
Vizita tekSulltan Bejazidi II 28
Sulltan Selim Han 34
Vizita tek Sulltan Sulejmani 42
Vizita tek Ebu Suudi 44
Vizita tek Sulltan Ahmedi 47
Gjurmë të paharruara 52
Mësimet prejperiudhës së rënies 53
Ëndërra e dytë 55
Vizitë tek Sulltan Mahmuti II 58
Vizitë tek Sulltan Abdulaziz Hani 61
Vizita tek Sulltan Abdulhamiti II 67
Vizitë tekSulltaneshë Behixhe 73
Vizita tekSulltaneshë Shadija 75
Vizitë tek dëshmorëte Çanakkalesë 79
Vizita e ditëve të sotme 83
Ti je një komb i madh 86

Një ëndërr plot përgëzime

Kur studiohen shumë ngjarje historike botërore evidentohet se fillesën dhe burimin e kanë pasur tek mendimet dhe imagjinatat e mëdha. Kur këto ngjarje që ndryshojnë historinë e botës kanë për qëllim fitimin e dashurisë së Allahut, paraprihen nga një sërë shenjash paralajmëruese. Edhe krijimi i shtetit osman i cili ka qënë një nga perandoritë më të mëdha të historisë, është paralajmëruar nga një përgëzim hyjnor.

Siç tregohet në shumë libra një natë kur pati qëndruar si mik në shtëpinë e Sheh Edebaliut, princi Osman pati përjetuar çaste plot emocione nën prehjen dhe kënaqësinë e kuvendit që i pati dhënë qetësi shpirtit dhe ia pati tulatur përpëlitjet e nefsit, egos, vetvetes. Sipas një rrëfimi, meqenëse në murin e dhomës që iu tregua për të fjetur, ndodhej i varur një tekst i Kur'anit të Shenjtë, ai s'mundi të shtrihej duke i zgjatur këmbët, prandaj u kredh në një gjumë të ëmbël ashtu, i ulur shuk, me këmbë të mbledhura! Në ëndërr pa se njëri skaj i hënës e cila po dilte nga gjoksi i Sheh Edebaliut dhe po merrte gjithnjë e më shumë formën e Hënës së Re si drapër, i hyri në gjoks, dhe një fidan rrapi që mbiu mes tij dhe Sheh Edebaliut, u shndërrua në një rrap madhështor, degët e të cilit u përhapën mbi

tre kontinente duke futur nën hijen e tyre shumë popuj e kombe. Në ato toka thirrej ezani, bilbilat këndonin Kur'an. Çdo anë e dukshme e qiellit ishte bërë trëndafilishte.

Duke i soditur në ëndërr me mahnitje dhe admirim të madh këto pamje, princi Osman vuri re një drenushë që u shfaq papritmas dhe u zgjua, ndërsa po merrte shenjë për ta gjuajtur me shigjetë drenushën që përpiqej të ikte drejt anës perëndimore.

Princi Osman mori abdest dhe, pasi kërkoi leje, hyri te Edebaliu. Ai nisi t'ia tregonte Edebaliut ëndrrën. Princi tregonte, kurse në fytyrën e Shehut shfaqeshin buzëqeshje të ëmbla, kurse sytë i shkëlqenin me një dritë sublime. Sheh Edebaliu e kishte zgjidhur, tashmë, me sytë e zemrës, enigmën e asaj ëndrre. Kur princi Osman heshti, Shehu ngriti kokën dhe, duke e vështruar princin mu në sy, filloi të fliste me zërin e tij të butë dhe melodioz:

"O bir, të fshehtën vetëm Allahu e di! Por në ëndrrën që ke parë ka plot mirësi e dobi. Zoti do t'ju mundësojë ty dhe brezit tënd mbretërim. Bota do të hyjë nën mbrojtjen e bijve të tu. Ti ke për t'u martuar me një vajzë nga vajzat e mia. Ata që do të lindin nga kjo martesë do të vihen në krye të një shteti të madh që ke për të ngritur ti e që ka për t'u zmadhuar gjithnjë e më shumë. Ky shtet do të zgjerohet drejt Perëndimit..."

Pa shkuar shumë kohë nga ëndrra që e shpjegoi Sheh Edebaliu, princi Osman u martua me vajzën e Shehut, Mal Hatun, zonjusha Mal. Kjo martesë mblodhi dhe bashkoi rreth Osman Gaziut forcën ekonomike dhe fisnikërinë. Kështu, u hodhën themelet materiale të shtetit i cili për gjashtëqind e ca vjet me radhë do të siguronte

drejtësinë botërore që do ta ndriçonte me anë të orientim.

Një ëndërr të tillë kishte parë i riu Osman Gazi dhe për të realizuar ëndrrën luftoi gjithë jetën. Po rinia e sotme çfarë ëndrrash kanë?

A keni menduar ndonjëherë?

A keni parë ju ndonjëherë një ëndërr të tillë kaq të bukur?

Ëndërra e një fëmije

Një fëmijë dymëdhjetë vjeç...

Një fëmijë që gëlonte mendja nga pikëpytje serioze në lidhje me jetën që bënte. Kush jam unë? Kush jam unë përtej të qenurit fëmijë i një prindi. Kush janë paraardhësit e mi? Nuk po gjente përgjigje për gjithë këto pytje të cilat i bluante më mendje.

Mendja dhe zemra i vlonte nga këtp pyetje ekzistenciale.

Ai ndodhet në këtë botë, do të jetojë për një kohë pastaj do të vdesë por si paraardhësit e tij.

Nata, dita dhe të gjitha fenomenet e kësaj bote i bënën një përshtypje të madhe dhe i lenin gjurmë në mendje dhe zemër.

A fitojmë apo humbim në këtë botë?

Gjyshi im përshembull është larguar i fituar apo i humbur nga kjo botë?

Sa njerëz ka që janë larguar nga kjo botë! Brezat zënvendësojnë njëri-tjetrin

Përballë kishte një pemë të madhe rrapi. Një pemë rrapi me shumë degë të mëdha ku secila prej tyre ndahej në shumë degë të vogla. Secila nga këto degë të vogla ushqente shumë gjethe jeshile. Menjëherë e ndjeu veten si një gjethe e freskët.

Gjethe e cilës pemë janë unë vallë? Nëse unë kam jetë, nuk mund të jemë pjesë e një peme të vdeukur. Prej cilës tokë ushqehen rrënjët e mia?

Djaloshi për të gjetur përgjigjet e këtyre pyetjeve u zhyt thellë në librin e historisë. Në një gjendje midis zgjimit dhe gjumit, sikur u fut në tunelin e kohës filloi të shohë një ëndërr:

Tarih baba

Në ëndërr u njoh me një të moshuar. Jeta e të moshuarit fillonte me Ademin (a.s). Emrin e kishte Tarih Baba. Në fytyrën plot dritë të tij pasqyronte historia e njerëzimit me të mirat dhe të këqijat e saj. Mbi vete mbante gjithë historinë, gjithëfarëlloj aventurash, ngjarje të dhimbshme, luftëra, gëzime, hidhërime dhe shumë e shumë ngjarje të historisë njerëzore.



Nga mjekra e bardhë, flokët dhe kërrusja kurrizit nga ngjarjet kuptohej që ishte shumë i vjetër. Fytyrë e tij ishte si një hartë.

E përkëdheli me dashuri ballin e djaloshit dhe i tha:

Bir! Të shikoj shumë të mërzitur, duket që ke diçka që të shqetëson. Por ajo që të shqetëson tani në një të ardhme të shkurtër do të shndërrohet në një burim gëzimi. Nëse shikon vetëm një pjesë

të gjithë filmit të historisë njerëzore nuk mund të bësh një vlerësim të drejtë dhe objektiv. Për të dhënë një vlerësim të saktë duhet të shikohet gjithë mozaiku dhe jo vetëm një pjesë e mozaikut. Ti je trashëgimtar i një brezi besimtar dhe të nderuar, gjyshërit tuaj ishin njerëz shumë të mëdhenjë. Prandaj edhe pse sot po përjeton apo po kalon ditë të vështira mos bjerë në pesimizëm, mos e humb shpresën. Mos u mashtro nga një lule që thahet para teje. Sepse në të ardhmen do të vijnë shumë pranvera të tjera plot lule. Kur të mërzitesh ngushëlloje veten duke menduar për të ditë bukura.

Tani do të dalim me ty në një udhëtim. Ti ngjarjet do t'i shikosh me syrin tim dhe do të mësosh të bësh një vlerësim të sakt.

Pastaj e mori djaloshin për dore dhe filluan të shëtisin.

Vizitë tek Osman Gazi

Sikur ishin në një botë krejt tjetër të panjohur. Tarih Baba tha:

Bir! Nuk kemi shumë kohë prandaj do të vizitojmë vetëm disa prej gjyshërve të tuaj.

Menjëherë dolën në prani të Osman Gazit, themeluesit të perandorisë Osmane.

Osman Gazi krijoi një shtet me katërqind kalorës. Gjithë jetën e tij e kaloi duke shërbyer në rrugë të Allahut. Vrapoi nga një luftë në një luftë tjetër, pothuajse nuk zbriti fare nga kali. Bëri një jetë modeste dhe dhe të thjeshtë larg çdo luksi, kur vdiq nuk i la asgjë trashgimi femijëve përveç armëve, pesë ose dhejtë kuaj dhe tre ose pesë dele.

Osman Gazi i pritë në këmbë ata. Ishte i veshur pastër dhe thjeshtë. Kishte një sjellje shumë fisnike. Në fytyrë i përvijohej qartë serioziteti dhe dinjiteti. Djaloshi përballë tij filloi të dridhej nga emocionet kurse Osman Gazi ishte shumë i qetë dhe i lumtur. Ai po shijonte shpërblimin e shërbime në rrugë të Allahut.

Kur takoi djaloshin iu kujtua rinia vet, i nguli sytë në horizont pastaj nzorri nga thellësia e zemrës një ah, sikur donte të kthehej në ditët e atëhershme. Sikur dëshironte të kthehej vazhdimish për të punuar në rrugë të Allahut dhe për të rënë dëshmor në rrugë të Tij. por jeta e kësaj botë të jepet vetëm një herë.

Pastaj fillojë të flasë më një qëndrim serioz.

Tha që njerëzit kanë nevojë për Islamin dhe bukuritë e tij

Muslimani duhet të jetë i mirë. Nuk duhet të mendojë vetëm për veten por edhe për të mirën e tjetrit. Demblezimi është një ves që nuk i ka hije asnjëriu prandaj muslimani duhet të qëndrojë sa më larg.

Muslimani duhet të jetë i sjellshëm, i dashur, i zgjuar dhe shoqërueshmëm me të gjithë. Pastaj tha:

Unë nuk jamë përzier në konfliktet e kota e të padobishme mes principatave apo feudave të Anadollit. Madje edhe me principatat Bizantine u përpoqa të kalojë në paqe. Në perëndim përparova vetëm për të bërë çlirime, luftova vetëm për të penguar padrejtësitë e tiranëve dhe despotëve. Shumë njerëz që panë sinqeritetin e trimave dhe ushtarëve të mi, na u bashkuan. Ndërtuam një kala të pathyeshme dashurie përreth vendit tonë.

Djaloshi përpiqej t'i kuptonte por kishte vështirësi në kuptimin e asaj që po thuhej. I hodhi një vështrim Tarih Babasë, i cili në shenjë miratimi tundi kokën.

Djaloshi me vazhdimin e bisedës filloi të kuptojë sukseset e mëdha të Osman Gazit. Ndërsa mendonte se cili ishte sekreti i këtyre suksesëve, Osman Gazi tha:

Puna më e madhe që mund të bëjë një shtet ësthë të sigurojë drejtësinë. Shteti nuk duhet të devijojë nga drejtësia, duhet të çrrënjosë padrejtësitë dhe drejtësia të shkoi në vendi e vet. Prandaj unë në jetën time kam marrë si shembull Omerin (r.a) Në të gjitha qytetet që çliroja dërgoja kadilerë për të siguruar drejtësinë.

Deshi të thoshte edhe diçka tjetër por ndaloi për një moment. Pasi i hodhi një vështrim djaloshit dhe Tarih Babës dhe vuri re që po e dëgjonin me vëmendje filloi të flasë:



Babai im Ertugrul Gazi nuk u nda për asnjë moment nga Sheh Edebali. Ai bëri gjithëçka për të treguar dashurinë dhe respektin ndaj tij, ai bëri gjithëçka për t'i shërbyer atij. Gjithashtu edhe unë shkoja shpesh pranë tij. Djalin tim të madh Aladdinin e dërgova pranë tij për t'i shërbyer. Këto po i tregoj sepse nëse një shtet fiton lutjet e miqëve të Allahut, ai shtet lartësohet mbi themele të forta dhe i zgjatet jeta. Babai im Ertugrul Gazi na ka dhënë këtë këshillë në lidhje me respektin që duhet treguar ndaj miqëve të Allahut.

"Shih, o bir!

Mua më zemëro, por Sheh Edebaliun mos e zemëro. Ai është dielli shpirtëror i fisit tonë. Peshorja e tij nuk gabon asnjë dërhem!

Kundërshtomë mua, por mos e kundërshto atë! Po të më dalësh kundër mua, hidhërohem, prekem, kurse po t'i dalësh kundër atij, s't'i hedh më sytë, edhe në t'i hedhsha, s'të shoh dot më!

Fjala ime është jo për të mirën e Edebaliut, por për të mirën tënde! Mbaji si porosinë time këto që po t'i them!"

Tarih Baba shikonte djaloshin për të kuptuar se çfarë po mendonte.

Osman Gazi dëshironte t'i tregonte nipit sa e rëdësishme është të qëndrosh në fjalën e dhënë, të mbash premtimin e dhënë. Sepse ky vyrtyt do t'i duhet shumë në jetë.

Shih bir!

Për njeriun gjëja më e rëndësishme është të jetë i besueshëm, të mbajë premtimin. Pa këtë virtyt nuk mund të bëjë asgjë. Njerëzit shkojnë pas një personi dhe karakteri që jep besim dhe siguri. Njerëzit i udhëheqin personalitet monumentale. Shoqëria gjithmonë kërkon njeriun që ka nevojë. Profeti (a.s)qysh në rini ishte bërë i njohur me virtytin e besnikërisë. Kjo veçori e tij ishte shndërruar në emrin e tij të dytë. Ai thirrej "Muhamed Emin"

Detyra jonë është të ndjekim rrugën e Profetit (a.s) dhe të jemi të drejtë dhe të besueshëm si Ai. Dhe ata që do përfitojmë më shumë prej kësaj përsëri do të jemi vetë ne.

Tani do të tregoj një kujtim shumë mësimdhënës që e kam përjetuar vetë:

Guvernatori dëshironte të pengonte rritjen e shpejtë të shtetit tonë i cili qëndronte mbi themele të forta. Ai duke provokuar edhe princër të tjerë bizantin organizoi një sulm të madh kundra nesh.

Ne me ndihmën e Allahut i mundëm ata. Governatori iku dhe u strehuar në Ulubat. Ne e rrethuam Ulubatin dhe kërkuam dorëzimin e guvernatorit. Guvernatori u Ulubatit kërkoi ta dorëzonte me kusht që ushtria jonë të mos e kalonte urën e Ulubatit.

Edhe unë i dhashë fjalën se nuk do ta kalojmë urën

Këtë fjalë që i dhashë mosbesimtarëve e mbajta deri në fund. Madje as pasardhësit e mi nuk e kaluan urën duke e mbajtë fjalën që kisha dhënë unë. Edhe kur u duhet të kalonin në krahun tjetër nuk e përdornin urën por kalonin me varka. Kjo sjellje e tyre më lumturonte shumë. Edhe tek ju besoj që ka plot shembuj të tillë.

Djaloshi po dëgjonte gjëra që nuk i kishte dëgjur asnjëherë

madje as nuk i kishte imagjënuar. Mendimet e trazuara që kishte në mendje filluan të qetësohen. Tani ndjente se në zemër po frynun flade të freskëta.

Osmani Gazi dëshironte të thoshte edhe dy fjali:

Birin tim Orhan Gazit i lashë një këshillë të cilën e respektoi dhe me ndihmën e Allahut pati shumë sukses. Të njëjta gjëra dëshiroj t'ia kujtoj juve dhe pasardhësve tuaj. Sepse të gjithë jeni bijtë e mi.

Qëndro jashtëzakonisht larg nga dhuna, padrejtësia, gëzojë njerëzit me drejtësi.Respektoji, shpërbleji dhe bëju mirësi dijetarëve të shquar (salih) e të virtytshëm që i japin forcë shpirtërisht shtetit. Kurrë mos u bëj krenar për ushtrinë dhe pasurinë tënde! Mos qëndro kurrë larg miqëve të Allahut. Dije se detyra jonë është rruga e Allahut, po ashtu, synimi ynë është ta mbajmë gjallë dhe ta jetojmë fenë e Tij! Kauza jonë nuk është një çështje e zbrazët dhe heroizmi, por lartësimi i Fjalës (fesë) së Allahut! Pra, gëzoma shpirtin duke mos e braktisur xhihadin, luftën në rrugën e Allahut!

Kur Osman Gazi përfundoi fjalën Tarih Baba dhe djaloshi kërkuan leje prej Osman Gazit dhe u larguan prej aty.

Vizitë tek Murat Hani

Ecën sëbashku në heshtje për disa momente. Pastaj filluan të bisedojmë për ato që dëgjuan prej Osman Gazit.

Tariha Baba tha:

Bir! Prej gjyshërve tuaj ka shumë personalitete të tillë që kanë arritur majat e historisë. Kur t'i njohësh do të shtohet mahnitja dhe shumë probleme në mendje do të gjejnë zgjidhje, në këtë mënyrë edhe zemra do të gjejë qetësi. Ta hajde me mua! i tha dhe e dërgoi tek heroi i luftës së Kosovës Murat Hani I. Gjaku mbi kaftanin e sulltan Muratit nuk ishte tharë akoma. Murat Hani I e kishte vizatuar hartën dhe kufijtë e një shteti të madhe me gjakun e tij.

Fytyra e sulltanit ishte plot gëzim dhe dritë. Po përjetonte qetësinë e daljes para Allahut me gjakun e dëshmorit. Ai kishte bërë një jetë të mbushur plot me shërbim dhe përpjekje në rrugën e Allahut. Ai nuk kishte qëndruar kurrë më shumë se një muaj në një vend, por kishte lëvizur për të përhapur fenë e Allahut në tokë.

Murat Hani I pasi i hodhi një vështrim djaloshit përballë filloi më një zë këmbues:



Bir! Gjithë sekreti qëndron në përdorimin e pasurisë dhe jetës në rrugë të Allahut në mënyrë që Ai të jetë i kënaqur me ne. Nëse jeton një jetë të tillë të pret një jetë pafund dhe një thesar i pashtershëm. Prandaj unë në luftën e Kosovës i luta Zotit kështu:

O Zot! Jepi fitore ushtrisë sime dhe mua më bëj kurban të kësaj fitorje, o Zot më më bëj të pijë sherbetin e martirizimit.

Ti nuk mund ta kuptosh sa më gëzon dhe lumturon fakti që ende në Kosovë thirret ezani. Tani në xhenet dëgjoj atë ezan të bukur.

Fitorja më e madhe e jonë është të biem dëshmorë në luftë për të përhapur dritën islame gjithë njerëzimit. Ne me të vërtetë:

Një mijë kalorës në sulme u gëzuam si fëmijë,
Një mijë kalorës atë ditë mundëm një ushtri si div...

Bir! Babai im Orhan gazi më pati dhënë këto këshilla:

O bir, mos u shmang nga urdhri i Kur'anit të Shenjtë! Sundo me drejtësi! Kujdesu për gazinjtë, luftëtarët fitimtarë! Ushqeji të varfërit! Dije si nder t'u shërbesh personalisht atyre që i shërbejnë fesë! Mos u vono t'i dënosh fajtorët, ata që ushtrojnë dhunë dhe padrejtësi! Drejtësia më e keqe është ajo që shfaqet me vonesë! Sado që në fund vendimi të jetë i drejtë, edhe drejtësia e vonuar është një lloj padrejtësie dhe përdhunimi!

O bir, unë kam arritur në fund të rrugës! Kurse ti je në krye! Zoti ta bekoftë mbretërimin!..

Kur u plagosa në fushë Kosovë thirra djalin, Bejazidin. Kur më pa mua gjithë gjak nuk i përmbajti lotët. Unë i dhashë këtë porosi:

Kush ka shpëtuar prej vdekjes në këtë botë që të shpëtoj unë? Nëse do të qashë qajë për shqetësimet dhe problemet e muslimanëve të cilët i ke nënpërgjegjsi.. mos i lërë ata në pozitë të vështirë. Në vendin tim do të kalosh ti. Përhap drejtësi në mënyrë që të duan njerëzit, duaj njerëzit dhe përpiqu të fitosh dashurinë e tyre. Bëhu një pasardhës i mirë në mënyrë që njerëzit të më kujtojnë për mirë. Mos harro kurrë se kulmi i pozitës dhe udhëheqjes është dretësia. Mos kujto se është një punë e lehtë drejtimi. Përkundrazi ajo është një nga punët më të vështirë në botë. Përpiqu të bësh një punë në mënyrë që të kujtojnë ata që do vijnë pas.

Pas kësaj këshillë historike Murat Hani e mbylli në këtë mënyrë:

Edhe ju dëgjoni dhe zbatoni këto porosi.

Djaloshi nga një anë po i dëgjonte me vëmendje nga ana tjetër filloi të djerësitej. Nuk mundi të thotë asgjë. Në këtë gjendje u larguan prej Murat Hanit sëbashku me Tarih Babën për të shkuar tek Sulltan Fatihu.

Vizita tek Fatih Sulltani

Pa mbërritur tek Sulltan Fatihu Tarih Baba i tregoi djaloshit për lindjen e Fatihut.

Babai i tij Murat Hani II po lexonte Kuran, konkretitsht suren Muhamed kur i dhanë lajmin e gëzueshmë për lindjen e djalit. Babai ngriti kokën dhe e quajti Muhamed djalin. Pa mbaruar fjalët Tarih Baba mbërritën tek Fatih Sulltani.

Sulltani Fatihu e kishte përfaqësuar denjësisht emrin që mbante. Ai kishte fituar konsideratën profetike " Sa komandant i mirë është ai!"

Kur mbërriti djali e gjeti të ulur në një front madhështor dhe të bukur sa që ishte e pamundur për ta imagjënuar imagjënata njerëzore. Djaloshi deshi te fliste gjithë respekt sepse shpresonte të merrte përgjigjet që i gëlonin në kokë. Por Fatih Sulltani ngriti dorën dhe nuk i dha mundësi djaloshit për të folur. Sulltan Fatihu tha:

Bir! Unë kam filluar të bëj planin e çlirimit të Stambollit qysh në moshën 14 vjeç. Si përgaditje për çlirimin e Stambollit kërkova

ndërtimin e kalasë Rrumeli. Planin e bëra gjithë vetë, pastaj punoi mbi të arkitet Muslihiddini. Për ndërtimin e saj punuam sëbashku me ushtarët me një enzizëm të madh. Unë vetë mbajta gurë për ndërtimin e saj. Gjashtë mijë ushtarë kanë punuar ditë-natë pa pushim për të ndërtuar atë kala, dhe në përfundim në një kohë rekord prej 32 ditësh ndërtuam Kalanë Rumeli.

Nëse e shikon nga sipër Kalanë Rumeli do të vësh re konjekturat e emrit Muhamed.

Rrethimi i Stambollit zgjati plot 53 ditë. Mua më kishte përfshi aq shumë marrja e Stambollit sa që thashë: O unë e marr Stambollin ose Stambolli mua"

Ndërkohë që ushtarët e mi trima po përballeshin me predhat e Rumëve, ata ngjiteshin në muret e Bizantit dhe me një emocion besimi të pakufijshëm thonin:

- Sot ka ardhur koha për të rënë dëshmorë!

Me zemrën plot besim Allahu na dha fitoren dhe arritëm të marrim Stambollin i cili konsiderohej i padëpërtueshëm. Në këtë mënyrë u plotësua edhe hadithi profetik.

Kjo fitore e madhe nuk na bëri dembelë dhe mendjemëdhenjë. 18 ditë pas çlirimit të Stambollit u përgaditëm përsëri në luftë në rrugën e Allahut.

Ndërkohë dua të tregoj edhe një kujtim tjetër:

Kishim dalë në fushatën kundër Perandorisë Bizantine të Trapezundit. Për t'iu afruar qytetit nga shpina, kalohej nëpër një terren malor dhe pyjor të dendur. Disa herë, spatarët ecnin para duke hapur rrugëkalimi. Në një vend ku rruga ishte e keqe, kali i im rrëshqiti. Duke u përpjekur për t'u mbajtur në një shkëmb, mu përgjakën duart. Zonja Sara, nëna e Hasanit të Gjatë, e cila na shoqëronte , duke menduar se ishte pikërisht çasti i përshtatshëm për atë që bluante ndërmend, iu drejtua sulltanit me këto fjalë:

"O bir, je sundimtar e bir sundimtari! Je një sovran i madh! A e vlen të heqësh kaq shumë vështirësi për një kala të vogël si Trabzoni?"

Hasani i Gjatë kishte pasë lidhur miqësi me Perandorinë Bizantine të Trapezundit, prandaj ia kishte dërguar nënën me lutjen që

të na bënte të hiqnim dorë nga ajo fushatë. Megjithëse isha i pëgjakur nuk u kthyem nga qëllimi, u çova në këmbë dhe i thashë:

"O nënë ! A s'e di ti se kjo që mbajmë në dorë është shpata e fesë islame? Mos pandeh ti se të gjitha këto mundime që po heqim janë për një copë tokë të thatë! Ta dish se të gjitha përpjekjet tona janë për t'i shërbyer fesë së Allahut! Për t'i futur njerëzit në rrugë të drejtë! Për të mos na u nxirë fytyra kur të dalim nesër para Allahut! Po qe se kemi në dorë mundësitë e kumtimit dhe lartësimit të vlerës së Islamit dhe parapëlqejmë rehatinë e trupit duke iu shmangur disa mundimeve, a do të mund të na thuhet neve gazinj, fitimtarë? Po të mos e çojmë Islamin te mohuesit, po të mos u bëhemi pengesë veprimeve të tyre shkatërruese, me ç'fytyrë do të dalim para pranisë hyjnore?"



Kjo që tregova shpreh qartë botëkuptimin në këtë botë dhe kauzën tonë për botën tjetër.

Sulltan Fatihu filloi të tregojë për virtytet dhe sjelljen e lartë të popullit. Tha:

Në periudhën time një musliman kërkonte ditë dhe nuk gjente një njeri të varvër për t'i dhënë zekatin. Pastaj e vendoste në një torbë dhe e varte në lagjen Xhagaloglu, mbi të shkruante:

Vëlla musliman! Megjithëse kërkova kudo për një të varfër për

t'i dhënë zekatin, nuk gjeta askënd të varfër. Nëse ke nevojë merrë pa asnjë hezitim.

Dhe kjo torbë rrintë e varur në pemë me muaj të tërë.

Shpresoj që edhe nipërit e mi vazhdojnë të jetojnë në të njëjtën mënyrë, po me ato virtyte dhe sjellje të lartë. Edhe ata duhet të jenë po aq të ndjeshëm, po aq bujarë dhe zemër mirë.

Djaloshi mori frymë thellë, i hodhi një vështrim Tarih Babës pastaj uli kokën.Mendoi thellë mbi ato që tha Fatihu. Megjithëse duhej të ishte i qetë vazhdonte ende të ishte i trazuar dhe i shqetësuar.

Nga gjendja e trazuar e djaloshit u shqetësua edhe Sulltan Fatihu. Fatihu u çua në këmbë për të treguar që mbaroi takimi.

Tarih Baba dhe djaloshi filluan rrugën për të takuar një nga themeluesit e kulturës dhe qytetërimit osman, Sulltan Bejazidin II.

Vizita tek Sulltan Bejazidi II

Bejazid Sulltani II ishte një sundimtarë i shquar dhe një besimtarë i mirë. Ai e mbarti xhenazen e babait Sulltan Fatihut deri në varreza. Ai e kishte kuptuar se një ditë edhe ai do të përfundojë në varr, dhe këtë të vërtetë nuk i doli kurrë nga mendja.

Sulltan Bejazidi e kishte kuptuar gjendjen e trazuar të djaloshit dhe filloi fjalën pa e pyetur djaloshi.

Biri im! Islami është si një aromë e këndshme që qetëson dhe fresokon zemrën, kur unë u ngjita në fron, arkitekti dhe piktori i madh italian Leonardo da Vinçi i pati shkruar një letër ku më propozonte që t'i bënte ai projektet e xhamive dhe veprave të tjera të Stambollit, kjo gjë pati shkaktuar një gëzim të madh mes vezirëve të institucionit Kubealltë. Mirëpo unë e refuzova këtë propozim kurse vezirëve u thashë kështu:

"Po qe se e pranojmë këtë propozim, në vendin tonë ka për të sunduar një arkitekturë si imitacion i arkitekturës kishtare për sa

i përket stilit dhe frymës, kurse arkitektura jonë islame nuk do të zhvillohet dot dhe nuk do të fitojë individualitet!"

Mos harro që vështirësitë dhe sprovat janë pjesë e kaderit po ashtu edhe ngjarjet dhe ndodhitë e gëzueshme. Ajo që i takon njeriut është të punojë sa të ketë mundësi. Suksesi ose dështimi pas përpjekjeve është në në dorë të Allahut.

Pasi u ngjita në fronin sulltanor në vitin 1481, vëllai im Xhem Sulltani gaboi rëndë. Ai bëri gjithëçka për t'u bërë sultan por Allahu ma kishte caktuar mua këtë mundësi. Ai nuk u kënaq me kaderin, por bëri gabime që cenonin unitetin dhe sovranitetit e perandorisë. Gabim që bëri e pagoi duke vdekur në tokë të huaj. Mos harro bir atdheu nuk copëtohet!

Vëllai im Xhem Sulltani e kupoti gabimin në fund.

Kur papa Inocenti VII i propozoi Xhemit të kthehej në krishter.

Ky propozim i rëndoi shumë Xhem Sulltanit. Ai u dëshpërua thellë dhe i tha kështu papës:

"S'e ndërroj fenë jo sikur të më jepni sulltanatin osman, por tërë botën!"

Nga ana tjetër, lutja e Xhem Sulltanit drejtuar Zotit pasi e kuptoi se kryqtarët kishin për qëllim ta përdornin kundër Islamit, është e mjaftueshme për të treguar pjekurinë e besimit tek ai. Ai dridhej si ndër ethe qoftë edhe nga ideja e mundësisë së shfrytësimit të tij kundër Islamit dhe i lutej kështu Zotit:

"O Zot! Po qe se qafirët kërkojnë të më përdorin si vegël për t'i shkaktuar dëm muslimanëve, mos e lër të jetojë më gjatë këtë robin tënd! Merrma një çast e më parë shpirtin për tek selia jote e lartë!"

Kjo lutje e vëllait tim u pranua që ai vdiq në Napoli në moshën tridhjetegjashtëvjeçare. Dhe, kur po vdiste, u la atyre që kishte pranë, këtë testament:

"Lajmërojeni vdekjen time patjetër në të gjitha anët! Ta bëni patjetër këtë, që lojërat që deshën të luanin qafirët mbi muslimanët duke më përdorur mua si pretekst, të marrin fund! Pastaj shkoni te im vëlla, sulltan Bajaziti dhe lutiuni që, sado vështirë që ta ketë, të ma sjellë kufomën në vatan. Unë s'dua të varrosem në një vend qafir! U bë ç'u bë gjer tani, të mos ma hedhë poshtë këtë lutje! Të

ketë mirësinë të m'i shlyejë të gjitha borxhet se s'dua të dal para Zotit me borxhe! T'i falë familjen dhe fëmijët e mi si dhe të gjithë ata që më kanë shërbyer! Dhe t'i kënaqë si ta kenë punën!.."

Kjo ndjeshmëri e tij më emocionoi, ia fala gabimin dhe ia plotësova testamentin. Të falësh është një virtyt i lartë.

Profeti (a.s) i ka dhënë një rëndësi shumë të madhe faljes së njëri-tjetrit. Sepse nëse njerëzit i falin gabimet njëri-tjetrit edhe Allahu i fal ata.

Sulltani u çua në këmbë. Djaloshi u qetësua pak nga ato që dëgjoi, zemrën ia kishte kapluar një dritë e ëmbël. Duke kërkuar leje u larguan nga sulltani.

Gjatë rrugës Tarih baba i tregoi për tërmetin që kishte ndodhur në kohën e Bejazitit të II në vitin 915 të hixhretit. Tërmeti i fuqishëm kishte shkaktuar dëme të mëdha në gjithë Stambollin. Në Stamboll ishin shkatruar qindra xhami dhe mijëra shtëpi. Një pjesë e mirë ishin shkatërruar krejt. Sultani Bejaziti ishte shumë i shqetësuar për gjendjen. Duke parë që muslimanët e kalonin natën dhe ditën nëpër çadra edhe ai qëndroi në çadër.Kur mori vesh që edhe në Edirne ishin bërë dëme të madhe u nis vetë për në Edirne për të parë dëmet e shkaktuara. Kur u afrua tek lumi Meriç pa që ura ishte shembur. Menjëherë mblodhi njerëzit dhe i tha:

-Vezirët e mi! Kaditë e mi, oficerët e mi, bejlerët e mi, ushtarët e mi! Ju e shikoni këtë fatkeqësi. Na ka ndodhur një fatekeqësi e madhe. Unë nga kjo kuptoj që ju keni bërë padrejtësi popullit, prandaj rishikoni veten dhe sjelljet tuaja. Kryeni detyrën tuaj me drejtësi! Mos i bëni padretjësi kujt! Kjo është një paralajmërim nga ana e Allahut. Unë po ju paraljamëroj se kush bën padrejtësi do ta largoj nga detyra.

Pas këtij tërmeti erdhën ustalarë dhe mjeshtra nga gjithë vendi për të rindërtuar vendin. Të gjitha shpenzimet u përballuan nga thesari i shtetit. Në çdo përvejtor të tërmetit shpërndahej ushqim për të varfërit tre ditë. Edhe vetë sulltani ulej dhe hante bukë me të varfërit.

Djaloshit nuk iu besonte sepse më parë nuk kishte dëgjuar kurrë një gjë të tillë. Nuk e kishte imagjënuar kurrë që ky sulltan të ishte kaq modest dhe kujdesej kaq shumë për popullin.

Djaloshi e kuptoi mirë se çfarë ishte xhihadi. Xhihadi është lartësimi i fesë së Allahut dhe përpjekja për të bërë një jetë në përshtatje me mësimet islame.

Xhihadi me pasuri dhe jetë që tregohet në Kuran dhe Hadithe nuk është vetëm lufta me armë sepse feja jonë e ka lejuar luftën vetëm për të çrrënjosur despotizmin dhe padrejtësinë dhe për realizuar drejtësinë. Çlirimet që kanë kryer të osmanët kanë qenë më shumë çlirime zemre. Me luftë mund të marrësh një kala por një zemër mund ta pushtosh vetëm me dashuri.

Feja jonë nuk e pranon luftën për të zgjeruar kufijtë apo për të pushtuar një vend. Lufta që bëhet për të pushtuar tokë është një padrejtësi e madhe. Kurse në islam lufta është një mjet për t'i siguruar njerëzve një jetë më të lumtur, të qetë dhe më të sigurtë.

Pastaj Tarih baba vazhdoi rrugën bashkë me djaloshin për të shkuar tek Sulltan Selimi.

Sulltan Selim Han

Sulltan Selimi qëndronte gjithë dinjitet dhe madhështi sikur po dëgjonte tekbiret që lartësoheshin nga betejat e Ridanijes, Merxhidabikut dhe Çaldëranit. Nga ana tjetër pasqyronte një modesti dhe përulësi si shërbyes i Mekës dhe Medines duke falënderuar Allahun.

Sulltani i foli kështu djaloshit që erdhi për vizitë:

"Me lejen e Allahut, arritëm fitore të mëdha, morëm titullin e shërbëtorit të dy qyteteve të paprekshëm! Allahu na favorizoi fitore në çdo kohë e në çdo vend! Por ne nuk u përfshimë nga mendjemadhësia duke ia atribuuar vetes gjithë këto fitore. Të gjithë sukseset dhe mirësitë janë prej Allahut.

Biri im! Ishim nisur në një ekspeditë ushtarake, në rrethinat e qytetit Adana na zuri një shi i furishëm. Gjithandej vendi u kthye në det balte. Me ne ishte edhe Kemal Pashazadenë, njërin prej dijetarëve të njohur të kohës, po ecnim mbi kuaj pranë e pranë duke kuvenduar. Papritmas, kali i Kemal Pashazadesë u tremb dhe balta e spërkatur nga këmba e kalit të trembur më spërkati me baltë.

Kemal Pashazade u dëshpërua shumë. Fytyra iu zbeh. Unë u ktheva nga ai, dhe i thashë:

"Balta e spërkatur mbi trupin tonë nga këmba e kalit të dijetarit, është nder për ne! Eshtë e bekuar! Kur të vdes, këtë kaftan të përbaltur të ma shtroni siç është mbi sëndukun (tabutin) tim!"

Bir gjatë tetë vjetëve që sundova perandorinë asnjë fitore nuk ia atribuova vetes, por të gjitha fitoret i konsiderova si një mirësi prej Allahut. Isha i vetëdijshëm se sundimi i botës ishte një gjë krejt pavlerë. Të jesh nxënës i një evlijaje është më lartë se sundimi i perandorisë.

Biri im! Duhet shumë punë në botën e sporves. Unë gjatë tetë vjetëve të sundimit, vetëm një pjesë të vogël kam kaluar në saraje.

Jeta ime ka kaluar në xhihad, natyrisht që edhe shpërblimi prej Allahut ka qenë shumëfish.

Tarih baba ishte i mahnitur prej Sulltan Selimit. Ai e njihte mirë atë, sa më shumë flitte aq më shumë i vinin kujtime nga jeta e Sulltan Selimit.

Fjalimi që pati mbajtur para parësisë jeniçere dhe burrave të shtetit pak para se të bëhej sulltan, kur e patën ftuar për në fron dhe pati ardhur në Stamboll, ia reflekton bukur qëllimin e vërtetë të zemrës, kërkesën për sakrifica dhe vuajtje:

"Po të bëhem padishah, do të eci me zeriozitet në rrugën e unitetit islam; po të më lejojë Zoti, do të shkoj në Indi dhe Turan dhe do të përpiqem në lindje dhe perëndim për lartësimin e Fjalës së Allahut! Nuk do të kem mëshirë për mizorin edhe sikur të jetë biri im! Në kohën time nuk do të ketë prehje, por popullit nuk do t'i bihet në qafë! Ja, ky jam e do të jem unë! Kurse im vëlla e do rehatinë dhe ka natyrë të butë. Po qe se nuk keni frikë nga lufta dhe e kërkoni vuajtjen dhe mundimin, jepmani besën mua! Në të kundërt, zgjidheni tim vëlla, princin Ahmed, dhe, atëherë, në kohën e tij, keni për t'u marrë me rehati dhe dëfrime!.."

Tarih baba sukseset e Sulltan Selimit i lidhte me ndjeshmërinë e tij ndaj haramit dhe hallallit.

Ka shumë ndodhi që tregojnë lartësinë morale të periudhës së sulltan Selimit të Rreptë. Gjatë marshimit për në Egjipt, në afërsitë e vendit të quajtur edhe sot Gebze, ushtrisë iu desh të kalonte pranë ose nëpër perimore dhe vreshta. Sulltan Selimi i Rreptë ra në mendime:

"A mos vallë ushtarët e mi këputën e hëngrën mollë dhe rrush pa lejen e pronarëve?"

E thirri again e jeniçerëve dhe e urdhëroi:

"Aga! Eshtë fermani im! Të kontrollohen hejbet e të gjithë jeniçerëve, spahinjve dhe këmbësorëve! Ushtari, në hejbet e të cilit gjenden mollë apo rrush, të sillet menjëherë para meje!"

Agai i jeniçerëve u vu menjëherë në veprim dhe i kontrolloi hejbet. Pastaj shkoi te sulltani dhe i raportoi:

"Sulltani im, nuk hasëm në ndonjë mollë ose veshul rrushi të këputur!"

Selimi i Rreptë u gëzua shumë nga ky lajm. U lehtësua nga pesha e mendimeve dhe dyshimeve. Pastaj, duke hapur duart, u lut:

"Lavdi të pafund ty, Allahu im, që më ke dhuruar një ushtri që nuk ha haram!"

Dhe i tha agait:

"Po qe se ushtarët e mi do të kishin këputur fruta pa leje, do të hiqja dorë nga fushata e Egjiptit, sepse është e pamundur të triumfohet mbi ndonjë vend me një ushtri që ha haram!"

Ai ishte shumë trim dhe guximtarë në betejën e luftës. Në luftën e Merxhidabikut ka luftuar krahë për krah me ushtarët.

Kur Sadrazami Sinan pasha i tha të lutem madhëri mos e hidh veten në rrezik! Sulltan Selimi i tha:

Ne jemi nipër të Sulltan Fatihut, nuk e drejtojmë luftën nga çadra.

Një herë erdhi lajmi se ambasadori i Venedikut do të vinte në Stamboll dhe do të dilte në audiencë ceremoniale. Atëherë, vezirët, duke ndjerë nevojën për t'i ndërruar rrobat që u ishin vjetëruar, ia njoftuan qoftë edhe me drojtje dhe shqetësim situatën sulltanit nëpërmjet kryeministrit. Selimi i Rreptë nuk u nxeh aspak, por tha:

"Me vend e kanë..."

Ditën kur do të vinte ambasadori, të gjithë vezirët u paraqitën te sulltani me veshjet dhe uniformat e reja. Mirëpo, duke mos i besuar asaj ç'po u shihnin sytë, mbetën të shtangur nga habia! Sulltan Selimi i Rreptë kishte mbi trup po ato rrobat e vjetra! Ishte ulur në fron, kishte hequr nga milli shpatën e tij të mprehtë dhe e kishte vendosur në shkallaren e fronit. Vezullimi i dritës së diellit që hynte nga dritarja përballë dhe reflektohej nga shpata, t'i merrte sytë! Para kësaj situate, të turpëruar për rrobat e pashme që kishin mbi trup, vezirët mbetën si të ngrirë.

Pasi përfundoi takimi dhe ambasadori doli jashtë, Selimi i Rreptë e vështroi kryeministrin dhe i tha:

"Pasha, zëre ambasadorin dhe pyete se ç'përshtypje pati nga takimi!"

Kryeministri e zbatoi urdhrin e sulltanit, u kthye dhe ia tha përshtypjet e ambasadorit me këto fjalë:

"Sulltani im! Ambasadori i Venedikut thotë: "Vezullimi i asaj shpate aq m'i mori sytë, sa s'e pashë dot mirë sulltanin!.."

Selimi i Rreptë buzëqeshi dhe, duke ia bërë me gisht kryeministrit shpatën, i tha:

Përsa kohë do të shkëlqejë shpata jonë armiqtë do të përulen para nesh. Nëse shpata jonë fillon të ndryshket atëherë ngadalë-ngadalë do të përulemi ne para armiqëve.

Ajo që e bënte trim dhe guximtar Sulltan Selimin ishte besimi i fortë.Për të marrë Egjiptin duhej të kalonte shkretëtirën e tmerrshme të Sinait të cilin nuk kishte mundur ta kalonte as Xhengizi as Timuri, ai arriti ta bënte këtë punë të vështirë brenda trembëdhjetë ditëve pa asnjë humbje, pa kaluar asnjë vështirësi furnizimi! Napoleon Bonaparti, madje, i cili konsiderohet si gjeni ushtarak, treqind vjet pas Selimit të Rreptë nuk arriti dot ta kalonte këtë shkretëtirë dhe ushtarët francezë të çmendur nga etja, patën qëlluar mbi njëri-tjetrin! Po të mendojmë se në Luftën e Parë Botërore, me mundësitë e reja teknike, kjo shkretëtirë u kalua vetëm pas njëmbëdhjetë ditësh, kuptohet më mirë madhështia e asaj që pati bërë Selimi i Rreptë!



Tek pashallarët dhe ushtarët kishte shumë lëkundje se si do të mund të kalohej shkretëtira e cila ditën ishte skëterrë nxehtësie, kurse natën, fushë akulli! Temperatura ditë-natë lëvizte nga +50 gradë në -20 gradë! Ishte si një det rëre!

Por ushtria hyri në shkretëtirë në sajë të vendosmërisë dhe vendimit të prerë të Selimit të Rreptë! Pas një farë

kohe, sulltani zbriti nga kali dhe nisi të ecte në këmbë. Udhëheqësit ushtarakë ishin të habitur e të tmerruar. Filluan pëshpëritjet: "Pse në këtë shkretëtirë ku kuajve u valon gjaku nga të nxehtit dhe ecin me vështirësi, sulltani zbriti nga kali dhe nisi të ecë në këmbë?"



Mes atij tmerri, edhe udhëheqësit ushtarakë zbritën nga kuajt dhe filluan të ecin në këmbë. Pashallarët, gjeneralët, i thanë shokut të ngushtë dhe njeriut të dashur të zemrës të sulltanit, Hasan Xhanit:

"Ç'të bëhet, pyete sulltanin, ç'punë e çuditshme është kjo?"

Dhe, kur Hasan Xhani e pyeti sulltanin se ç'kuptim kishte veprimi i tij, ai iu përgjigj:

"Hasan, a nuk e sheh se para nesh është duke ecur në këmbë i Dërguari i Allahut (a.s.)? Kur ai, sovrani i botëve të ecë në këmbë, si mund të qëndrojmë ne mbi kuaj?"

Tarih baba kishte mbetur si i ngrirë përballë ngjarjeve që i kalonin si një film para syve. Në lidhje me botën shpirtërore të Sulltan Selimit iu kujtua edhe kjo:

Kur Sulltani Selimi mori lajmin e lindjes së djalit, ishte duke lexuar Kuran. Ngriti kokën dhe tha emrin ia vendosa Sulejman. Pastaj vazhdoi të lexojë kur në atë moment lexoi ajetin:

Ajo (letër) është nga Sulejmani dhe citon: "Me emër të Perëndisë, Mëshiruesit dhe Përdëllimtarit të Madh! (Neml, 30)

Tarih baba u zgjua nga meditimi i thellë që kishte rënë. Në këtë mënyrë u ndanë nga Sulltan Selimi.

Rrugës Tarih baba i tha djaloshit: Sultan Selimi flinte shumë pak gjumë. Një pjesë të mirë të natës e kalonte duke lexuar. Nuk i jepte shumë rëndësi veshjes dhe pamjes së jashtme. Kur e pyetën njëherë për shkakun tha:

Veshja bukur e vezirëve dhe pashallarëve është për t'u dukur bukur përballë sulltanit. Ne nuk kemi kujt t'i dalim para përveç Allahut dhe para atij duhet të dalim bukur me vepra dhe sjellje.

Pas kësaj Tarih baba dhe djaloshi do të vizitonin Sulltan Sulejmanin.

Vizita tek Sulltan Sulejmani

Sulltan Sulejmani ishte i mendueshëm, po shikonte në horizont, sikur po dëgjonte krismat e topave nga deti mesdhe. Kur pa Tarih babanë dhe djaloshin mori frymë thellë dhe tha:

Unë u bëra shtylla e pathyeshme e drejtësisë në tre kontinente. Shkova deri në Gjermani mbi kalë, ka që shkojnë edhe tani me mjete të tjera por shkaku pse qëllimi pse shkojnë a dini gjë?

Biri im! Barbaros Hajredin Pasha i kishte shkaktuar disfatë të rëndë në Prevezë Andrea Dorjas i cili mezi e kishte shpëtuar jetën duke e braktisur flotën e duke ikur.

Duke i vënë para galerat armike me direkët të rrafshuar pëdhé dhe të mbushura me mijëra robër, Barbarosi po hynte nga Briri i Artë në Gji. Krejt sipërfaqja e detit ishte e mbushur me galerat armike.

Ligjvënësi, vezirët dhe pashallarët po e soditnin këtë pamje

madhështore nga një vilë bregdetare që nuk është më sot. Njëri nga pashallarët i tha sulltanit me emocion:

"Sulltani im, sa herë, vallë, e ka soditur bota një pamje të tillë? Sado që të krenoheni ju, e keni pak!"

Kurse sundimtari i madh ia ktheu:

"Pasha! A na takon neve të krenohemi apo ta falenderojmë me madhërim Zotin tonë të lartë që na i dhuron këto fitore?"

Pa asnjë dyshim që ky mbretërim shpirtëror i Ligjvënësit, më madhështor e i shkëlqyer se mbretërimi material botëror ishte rezultat i frymëzimit dhe ndihmës që pati marrë ai nga robtë e vërtetë të Allahut!

Pastaj Sulltan Sulejmani u çua në këmbë. Tarih baba dhe djaloshi shkuan për të takuar një dijetar të madh siç është Ebu Suudi.

Vizita tek Ebu Suudi

Dijetari i madh Ebussuud Efendi i cili, krahas poezive në arabishte, persishte dhe turqishte, kishte edhe vepra të ndryshme fetare, i cili, përveç detyrave si myderris, kadi (gjykatës) dhe kazasker, pati kryer edhe detyrën e shehulislamit, qe Shehulislam në periudhën e sulltan Sulejman Kanuniut-Ligjvënësit. Ky dijetar i transmetoi një kujtim në lidhje me Sulltan Sulejmanin Tarih babasë dhe djaloshit.

Një ditë, sulltan Sulejman Ligjvënësi, me anë të një dyvargshi poetik, i kërkoi fetva (vendim juridiko-fetar) shehulislamit Ebussuud Efendi për t'i vrarë milingonat që po i thanin drurët e dardhave në kopshtin e pallatit: Nëse milingonat bëjnë dëm në drurë,

A ka ndonjë të keqe për t'i vrarë?

Kësaj kërkese të padishahut, edhe shehulislami Ebussuud Efendi i dha përgjigje poetike me një dyvargsh të tillë:

Nesër kur të dalë para gjyqit të Zotit,
Milingonat ia marrin hakun Sulejmanit!

Sulltan Sulejman Kanuniu-Ligjvënësi i cili kishte kaluar nëpër



një edukim moralo-shpirtëror aq të përkryer sa që të druhej për t'i prekur edhe milingonat, madje, ishte edhe një komandant ushtarak i talentuar, edhe një burrë shteti shumë i zgjuar dhe organizator, edhe një personalitet dijetar dhe letrar.

Ligjvënësi ishte shumë i aftë për t'i zgjedhur burrat e shtetit dhe për t'i ngarkuar me detyrë. Megjithëse ishte jashtëzakonisht tolerant, s'i falte kurrë veprimet kundër fesë dhe shtetit.

Ngaqë ishte respektues ndaj ndjenjave të popullit dhe ushtarëve, duhej shumë nga të gjithë. Gjatë periudhës 46-vjeçare të mbretërimit të tij, nuk pati pasur qëllim dhe synim tjetër veç lartësimit të fesë së Allahut!

O Bir! Nëse dëshironi të sundoni përsëri botën duhet të rifitoni virtytet, drejtësinë dhe moralin e lartë që këni humbur. Nëse nuk

e vlerësoni jetën dhe ngjarjet që ju dalin përpare sipas moralit, drejtësisë dhe mendjes së shëndoshë nuk do të arrini kurrë të rikthehemi epokës së lavdishme.

Djaloshi kishte mbetur i mahnitur nga ngjarjet dhe këshillat që kishte dëgjuar.

Tani kishte formuar një identitet të ri. Ndërsa më parë ishte si një gjethe duke u tharë tani kishte gjetur rrënjët. Damarët i ishin mbushur me jetë përsëri.

Tarih baba u kthye nga djaloshi dhe i tha:

Bir! Këto këshila dhe sugjerime që more kuptojë mirë në mënyrë që të arrish t'ia tregosh edhe shokëve.

Bir! Sot do të takojmë Sulltan Ahmetin dhe Aziz Mahmut Hydajin. Deri tani kemi parë epokën e ngritjes dhe zhvillimit. Një herë tjetër do të shikojmë epokën e rënies dhe degradimit.

Do të vizitojmë Abdulhamidin i cili kur mori vesh që kalaja e Ozit ra në dorën e armikut dhe në të u vranë shumë ushtarë, nga hidhërimi ndërroi jetë. Do të shkojmë në Çanakkale. Do të vizitojmë herojntë e luftës për pavarësi.

Por tani të vizitojmë Sulltan Ahmetin dhe të marrim bekimet e Aziz Mahmut Hydajit.

Vizita tek Sulltan Ahmedi

Tarih baba dhe djaloshi kur hynë tek Sulltan Ahmeti e gjetën në një gjendje dhe atmosferë dashurie ndaj Profetit (a.s) të cilin e donte më shumë se veten dhe gjithëçka tjetër.

Pranë tij ishte një person tjetër. Sytë i kishte të mbyllur ndaj dynjasë dhe të hapur ndaj Ahiretit. Me një shikim të thellë dhe të gjërë përtej horizontëve sikur ishte zhytur në një botë tjetër. Ky person ishte Aziz Mahmud Hydaji. Fytyrën e kishte të mbushur me teqësi dhe buzëqeshje.

Sulltan Ahmeti ishte zhytur në një gjendje qetësie dhe heshtje. Por kjo heshtje dhe qetësi ishte aq e bukur sa nuk mund të përshkruhet me fjalë.

Aziz Mahmud Hydaji duke menduar djaloshin u kthye nga djaloshi dhe i dha këtë këshillë:

Biri im! Shpresoj që vakfi që kam hapur për t'i shërbyer nxënsve, të dobtëve, të varfërve, të vobektëve dhe jetimëve, të vazhdojë të shërbejë.

Zogjt që fluturojnë prej folesë së Hydajit rrahin krahët drejt horizontëve. Një zog e bën vezën në fole. Prej këtyre vezëve dalin zogj, pastaj këta zogj të vegjël krijojnë në fole tjetër. Prandaj ata që dalin prej kësaj foleje shpresohet të ndërtojnë fole të tjera dashurie dhe mëshire atje ku shkojnë.

Bir! Vakfi është shumë i rëndësishëm. Pronat që kanë lënë vakëf Profeti (a.s) dhe sahabët janë një shembul konkret për ne. Shpërblimet që fitohen prej vakëfit vazhdojnë edhe pas vdekjes së dhuruesit.

Duke u nis nga kjo shumë njerëz gjatë gjithë historisë kanë lënë prona vakëf.

Zemra të tilla të dhembshura janë bërë një strehë e ngrohtë për mijëra njerëz. Falenderojmë Allahun që vakëfi që kemi krijuar vazhdon t'i shërbejë njerëzve prej qindra vitesh.

Bir! Njerëz si Hydaji dalin gjithmonë. Koha juaj pret njerëz si Hydaji por ajo që është e rëndësishme është dëshira e madhe për të qenë si ai.

Dikur të parët tanë kanë qenë përfshirë nga një entuziazëm i tillë, dhe kjo gjendje i hapu atyre oqeane, kjo gjendje i bëri atë të sundojnë mbi tre kontinente. Nga Kaukazi, deri në Ballkan, nga Afrika deri në Sham. Ishte pikërisht kjo frymë që çliroi Stambollin. Ishte përsëri kjo gjendje shpirtërore që i bëri atë të sundojnë me drejtësi.

Kjo atmosferë vinte nga dashuria për Allahun.

Kjo atmosfere vinte nga respekte për Profetin (a.s.).

Ky ishte një entuziazëm që vinte nga dëshira për të udhëhequr me drejtësi.

Kjo ishte një dashuri për njeriun si qenie.

Kjo ishte një dashuri për lumturinë e përjetëshme.

Me këtë dashuri gjyshërit tuaj arritën fitore të mëdha dhe të shumta duke u shndërruar në një nga perandoritë më të mëdha të kohës. Ata realizuar vepra të cilët edhe armiq nuk i kishin imagjënuar.

Biri im! Nëse Allahu e do një person, Ai e bën të dashur atë

edhe për njerëzit e tjerë. Shiko za njerëz vijnë për të më vizituar mua. Allahu qoftë i kënaqur prej tyre.

Vdes njeriu mbetet vepra. Nuk duhet të qahet për atë që ikën nga kjo botë por për atë që nuk le asgjë kur ikën nga kjo botë.

Ne hapëm një derë mirësie, vazhdimi i saj është detyrë e juaja. Ajo derë me përpjekjet e tuaja duhet të qëndrojë hapur deri në ditën e gjykimit. Dhe përveç kësaj duhen hapur dyer të tjera.

Mos harro që çdo vështirësi dhe sprovë të pjek më shumë. Toka nuk arrin pranverën pa kaluar vështirësitë e dimrit. Nëna nuk mund të bëhet me fëmijë pa e mbajtur nëntë muaj në bark dhe pa kaluar vështirësi.

Biri im! Unë po shikoj që shërbimet që po i ofrohen atdheut

dhe popullit janë aq të mëdha së nuk mud të përshkruen. Herojntë shpirtërorë nuk kanë për të vdekur kurrë. Edhe ti ec në këtë rrugë.

Hydaji do të dëshirontë të vazhdonte për në atë moment u këndua ezani i sabahut dhe kjo ëndërr e gjatë mbaroi.

Djaloshi u zgju në një gjendje krejt tjetër. Doli në penxhere dhe bëri këtë lutje.

O Zot! Na bëj edhe në si gjyshërit tanë. Na bëj të mundur të shërbejmë edhe në në rrugën e fesë dhe vendit!

Amin!

Gjurmë të paharruara

Djaloshi që bëri një udhëtim historik në ëndërr me Tarih babën filloi të ndjejë ndryshme në botën shpirtëore dhe intelektuale. Gjendja shpirtërore dhe madhështore e gjyshërve të tij të cilit i vizitoi lanë tek ai gjurmë të paharrueshme. Ai filloi të vizitojë të gjithë trashgiminë e madhe dhe madhështore që kishin lënë ata. Kjo gjë i kishte ngjallur një kureshtje të madhe në lidhje me historinë. Prandaj filloi të lexojë librat e historisë që trajtonin historinë madhështore të të parëve të tij. Sa më shumë lexonte aq më shumë i shtohej dashuria për trashgimërinë historike dhe kulturore.

Mësimet prej periudhës së rënies

Kur po lexonte arriti tek periudha e ashtuquajtur periudha e tulipanëve. Kjo periudhë karakterizohet nga dhënia pas kënaqësive, dëfrimëve dhe argëtimëve duke lënë në këtë mënyrë pas dore shërbimet në rrugën e Allahut. Në këtë periudhë mbisundoi jetesa boheme dhe zhvlerësimi i vlerave moralo-etike dhe shpirtërore. Kjo gjë i shkaktoi shumë dhembje dhe hidhërim djaloshit. Kur mësonte se si ishte grabitur gjithë ajo trashëgimi i pikonte gjak nga zemra.

Veçanërisht këto fjali i përmbysën mendimet:

Forca moralo-shpirtërore që e kishte ngritur lart shtetin u humb, nisën të dalin në pah krenaria materiale boshe dhe prirjet e nefsit, nisën të dalin në plan të parë dëfrimet, fryma e ngadhnjimit u lëkund dhe ngadhnjimi u ndërpre, ashtu që pati kohë kur rrënja qepore e një tulipani u shit një flori! Kështu, fati i një shteti të madh ndryshoi. Mbishpenzimet e shtuan luksin. Me shtetet perëndimo-

re nisi gara e shkëlqimit. Eshtë tejet domethënës fakti që, përveç kompleksit arkitektural si seli perandorake, të quajtur Topkapi, të gjitha pallatet dhe kommplekset e tjera arkitekturore të këtij karakteri u përkasin viteve të fundit të osmanëve!

Djaloshin e mundonin shumë këto të vërteta, prandaj këto ditë po i kalonte i brengosur. Në gjendje të mërzitur tha me vete: ah Tarih Baba! Për të më përjetuar këto dhimbje dhe vuajtje më dole përpara?

Pastaj e dha vetë përgjigjen:

Jo! Tarih baba dëshirtonte të më tregonte të vërteta dhe të vëtëdijësohesha për to. Pra nuk duhet të biem në gabimet që kanë rënë të parët tanë, dhe kjo arrihet duke nxjerrë mësim.

Heshti. Deri në atë moment i kishte treguar gjithë shokëve për historinë por tani i vinte turp t'i tregonte.

Ëndërra e dytë

Djaloshi ishte krejtësisht i turbullt. Kokën e kishte vendosur mbi jastëk por gjumi nuk kishte megjithë se ishte bërë shumë vonë. Por papritur u gjend në një ëndërr. Përsëri i doli përpara Tarih baba. Pasi i hodhi një shikim të mprehtë tha:

Bir! Edhe shtetet lindin, rriten xhvillohen dhe vdesin si njerëzit. Ky është ligj për të gjithë. Por ajo është është e rëndësishme kuptimi i urtësive dhe nxjerrja e mësimëve prej historisë. Siç e ke kuptuar edhe ti kur ndrysho qëllimi dhe synimi në zemër duke u dhënë pas veseve dhe kënaqësive ndihma e Allahut ndërpritet.



Shtetet lindin si një fis, pastaj forcohen dhe marrin pamjen e shtetit, kur zgjerohen marrin formën e perandorisë. Shtetet që mbështeten në drejtësi, moral dhe vlera shpirtërore jetojnë më gjatë ose më saktë jetojnë për sa kohë i respektojnë këto vlera. Por kur largohen nga vlerat islame dhe fillon de-

ngegrimi moral atëherë fillon rrënimi dhe zhdukja nga historia. Pastaj mbi to lindin shtete të reja të cilët e vazhdojnë jetën sipas mundësive. Kjo gjendje është për të gjithë shtetet në botë. Sepse në këtë botë nuk ka asgjë të përhershme. Pas rrijes fillon rënia por edhe rënie nuk është e përhershme nëse fillon përmisimi shpirtëror fillon përsëri ringritja.

Ata që e shikojnë gjithçka nga dritarja e rënies janë gjithë jetën pesimistë kurse ata që e shikojnë gjithmonë nga dritarja e rritjes përfshihen nga një optimizëm bosh. Mënyra e duhur është të ndiqet rruga e mesme. Vetëm ata nxjerrin mësime dhe arrijnë të kryejnë dhe të bajnë detyrën që u takon. Historia në fakt përsëritet për atë që nuk nxjerrin mësim prej saj. Siç thotë Mehmet Akifi:

E përkufizojnë historinë si përsëritje,
a ishte përsërit historia sikur të nxirrej mësim!

Në fakt përsëritja e historisë është një mirësi me madhe për të mençurit. Njerëzit e pjekur duke nxjerrë mësim prej kësaj fillojnë të përjetojnë përsëri epokën e artë kurse prej epokës së rënies nxjerrin mësim dhe nuk përsërin të njëjtat gabime. Në këtë mënyrë i japin drejtim të ardhmes.

Tarih baba mori frymë thellë dhe tha:

Eja bir! Tani do të vizitojmë venden që nuk i kemi vizituar herën e parë. Në këtë mënyrë mëson arsyen përse shteti jonë mbeti mbrapa.

Në fillim të vizitojmë Sulltan Mahmutin II.

Vizitë tek Sulltan Mahmuti II

Sulltan Mahmut II ishte i mërzitur, sytë i kishte të përlotur, trupin e kishte të dobët dhe të hollë. Kur hyri djaloshi kthehu kokën dhe tha:

Bir! Shumica e vakëfëve që janë në Mekë dhe Medine mbajnë vulën time. Falënderoj Allahun që më dha mua mundësinë për të shërbyer në këtë vende të shenjta.

Por herë pas herë rashë preh e mashtrimëve të njerzëve të shtetit, dhe në këtë mënyrë bëra disa gabime. Një pjesë e njerëzëve më thonin: "Sulltani kaurr" kjo ishte shumë e rëndë për mua. prandaj jeta ime të jetë mësim për ju. Në fakt nuk desha të ndodhte kështu. Unë nuk desha të ndiqnim perëndimit në mënyrë të verbër, kjo ishte turp për shtetin dhe popullin tonë. Jeta më kaloi pendim për gabimet e mia. Kur i pashë gabimet e mia kërkova të shkoj në një xhami dhe aty të jap frymën e fundit.

Ju lutem o bij! Nxirrni mësime nga ato që kam bërë unë. Kini



kujdes mos e humbni identitetin fetar dhe kombëtar, mos e humbni moralin tuaj!

Sulltani u çua në këmbë me sy të përlotur, sikur nuk dëshironte të shikonin lotët në sytë e tij. pastaj Tarih baba dhe djaloshi u nisën për të takuar Abdulazis Hanin.

Vizitë tek Sulltan Abdulaziz Hani

Sulltan Abdulazizi krahasur me babain e tij ishte shumë më hijerëndë dhe më solemn. Kishte një shtatlartësi që arrinte deri në dy metra. I ngjasonte më shumë gjyshit të tij Sulltan Selimit. Kur e pamë ne ishte si në gjendjen kur ra dëshmorë. Mbi tavolinë kishte një Kuran të vogël, në ato momente po lexonte suren Jusuf. Mbi libër kishte pika gjaku. Por Sulltani ishte i kënaqur me shpërblimin hyjnorë që i ishte dhënë.

Pasi i hodhi një vështrim të thellë djaloshit filloi të flaësë:

Biri im! Në kohën time ata që deshën të shkatrrojnë perandorinë osmane na quanin "i sëmuri i Bosforit"

Por unë arrita ta çrrënjos këtë njollë. Unë krijova flotën më të fortë në botë. Kjo flotë nuk e la me morë frymë flotën angleze. Perendimorët i bënin shërbimet e anijeve në kantieret tona të flotës. Në këtë mënyrë unë u bëra promotor i ringritjes që kishte filluar me Xhon Turqit. Kur vizitova Francën njerëzit kishin dalë në rrugë

gjithë entuziazëm për të më pritur. Vizita ime në Francë ishte një burim krenarie për ta.

Qëllimi i reformave dhe veprimtarisë sime ishte të ndaloja imitimin e verbër që i bëhej Evropës. Unë u përpoqa të përparojmë dhe zhvillohemi pa e humbur identitetin feta dhe kulturor tonin.

Duhej forcuar dhe mbrojtur kultura kombëtare. Ne duhej të merrnim teknologjinë dhe të qëndronim sa më larg shthurjes morale të Evropës.

Për këtë arsye unë rashë dëshmorë.Bir nëse tani jam në një gradë të lartë kjo ka ardhur sepse jam distancuar nga mendjemadhësia dhe arroganca e pushtetit dhe kam bërë një jetë të thjeshtë dhe në përputhje të plotë me rregullat e fesë sonë. Gjatë gjithë jetës në vend të ujit kam pirë ujë Zemzem. Madje kur vizitova Evropën ujin e abdesit e kam more me vete prej Stambolli. Rregullisht falja namazin dhe lexoja Kuran. Zemrën e kisha të mbushur me salavatet për Profetin (a.s) Prandaj tregova një respekt dhe kujdes të veçantë për popullin e Medines.

Një ditë, ndërsa ndodhej në shtrat i sëmurë e zverdhur, adjutantët i thanë sulltan Abdylazizit:

"Ka ardhur një lutje nga komshinjtë e Medinës së Ndritshme!"

Atëherë, ai u tha adjutantëve:

"Menjëherë më ngrini në këmbë! T'i dëgjoj në këmbë kërkesat e ardhura nga qytetet e shenjtë! Kërkesat e komshinjve të të Dërguarit të Allahut nuk dëgjohen shtrirë me këmbët zgjatur në mënyrë të huaj për edukatën dhe etikën!"

Me këto fjalë ai e shfaqte bukur dashurinë që ushqente për Medinën dhe Profetin (a.s.)!

Sa herë që vinte posta e Medinës së Ndritshme, merrte sërish abdest, i puthte dhe i vinte në ballë letrat duke thënë se "në to është pluhuri i Medinës së Ndritshme", pastaj ia zgjaste kryesekretarit duke i thënë: "Hape dhe lexoje!"

Dashuria për Profetin (a.s) dhe Medinen ka qenë jashtëzakonisht e madhe dhe më e rëndësishmja për mua. kur më vinte ndonjë letër nga Medina nuk e hapja pa marrë abdes.

Gjithmonë e puthja duke menduar se në të kishte pluhur nga qyteti i Medines.

Si pasojë e kësaj dashurie tani shpirti im është i qetë dhe prehet në paqe.

Këto fjalë të Sulltanit i kishin hapur një horizont tjetër djaloshit. Edhe Sulltani kishte mbetur shumë i kënaqur nga biseda me një djalë kaq të vyer.



Djaloshi u ndikua shumë nga gjendja e Sulltan Abdulazizit.

Djaloshi i kërkoi Tarih Bababës t'i tregonte ndonjë kujtim nga jeta e këtij Sulltani të madh. Tarih Baba tha:

Sulltan Abdylazizi që i kishte ngritur ushtrinë dhe flotën në një nivel sy-

verbues, që i kishte eliminuar mjeshtërisht konfrontimet dhe konfuzionin e brendshëm, për rrjedhojë, që kishte filluar ta lartësonte kredibilitetin e shtetit drejt nivelit të dikurshëm, më në fund, tërhoqi interesimin e të gjithë botës. Prandaj, sulltani u ftua në Francë dhe Angli.

Sulltani shqetësohej shumë për punët e shtetit dhe për këtë ishte sëmurë tre ditë rresht.

Një nga shëbimet më të mëdha të Sulltan Abdulazizit ishte ndërtimi i rrjetit hekurudhor. Në saje të sistemit hekurudhor që ndërtoi ai u bë e mundur transmetimi shumë i lehtë i ushtarëve gjatë luftës së parë botërore. Ai nuk u mjaftua vetëm me kaq por ndërtoi rrjetin telegrafik. Në këtë mënyrë u bë më e lehtë për të marrë vesh çfarë ndodhte në botë.

Tarih Baba në lidhje me thjeshtësinë, përgjegjsinë dhe dashurinë për atdhe të Sulltan Abdulazizit transmetoi një kujtim:

Dëshira e Abdulazizit

Abdulazizi pasi pranoi ftesën për të vizituar Evropën i shprehet me një sinqeritet të plotë në këtë mënyrë nënpunësit Mehmet Bej:

...A e di çfarë dëshiroj herë pas here? Dëshiroj të jem një zanatçi ose një tregtar i vogël që punon në dyqanit e vet të vogël. Të dal në mëngjes nga shtëpi për të shkuar në punë dhe në darkë të kthehem tek familja me atë që më ka caktuar Allahu. Të vija në shtëpi i lodhur fizikisht por shumë i qetë psikologjikisht dhe mas një kokëçarje. Kur të mbërrijë në shtëpi të më presin

bashkëshortja dhe fëmijët, pastaj të hanim darkën të gjithë sëbashku. Do të dëshiroja shumë të bëja një jetë të thjeshtë dhe larg angazhimëve dhe preukopimëve të mëdha.

Ndërsa Ali dhe Fuad pasha më kërkonte të vizitoja Francën a e di çfarë mendoja? Dëshiroja të shkoja në evropë me shpenzimet e mia dhe pa ndonjë pozitë shtetërore. A nuk dëshiroj unë të vizitoj Evropën? Por kur shkon në pozitën e Sulltani e gjithë vëmendja e publikut është mbi ty. Në jemi dënuar të mos marrim frymë lirisht midis popullit dhe njerëzve.

Një ngjarje tjetër shumë e rëndësishme që ka ndodhur në kohën e Abdulazizit është edhe kjo:

Imam Shamili i cili kishte bërë një luftë heroike për pavarsinë e Kaukazit, fatkeqësisht ra rob në dorë të rusve. Me kushtin që njëri nga djemtë të qëndronte peng në Rusi i dhanë leje për të shkuar në Haxh.

Imam Shamili fillimisht erdhi në Stamboll.

Sulltan Abdulazizi e priti shumë ngrohtë duke i anashkaluar të gjithë portokollin shtetëror. E përcoli atë deri tek porta e pallatit mbretëror. Tek porta i tha:

Vetëm po të ringjallej babai im do të gëzohesha kaq shumë sa më gëzoi takimi me ty.

Pastaj shtoi:

Miku im shumë i vyer! Ti je i mirëpritur në çdo cep të vendit tim. Plotësimi i çdo nevojë dhe dëshire tuajën dhe familjes tuaj është dëtyre për mua dhe qeverinë time.

Imam Shamili u emocionua shumë nga këto fjalë. Pasi e falënderoi thellësisht nga zemra i tha:

Nuk kam asnjë dëshirë materiale as për veten as për familjen. Dëshira ime e vetme është të shkoj në Medine, të jetoj afër Profetit (a.s) dhe të bëj ibadet atje.

Djaloshi gjendej në një gjendje midis gëzimit dhe hidhërimit. Fillo të eci si i përhumbur mbas Tarih Babës.

Tarih Baba i tha: Tani eja të shkojmë të takojmë një nga sulltanët më të mëdhenjë dhe të aftë të perandorisë Osmane, Sulltanin Abdulahamitin II.

Vizita tek Sulltan Abdulhamiti II

Sulltan Abdulhamiti e priti Tarih Babën dhe djaloshin në këmbë. Pritja në këmbë e një mysafiri nga Sulltani ishte në kundërshti me rregullat shtetrore. Por Sulltan Abdulhamiti karakterizohej nga një modesti dhe thjeshtësi e theksuar.

Djaloshi mbeti i habitur nga pritja që i bëri gjithë ky sulltan. Filloi ta vështroi gjithë mahnitje. Sulltan Abdulhamiti po shikonte në horizont, i shte zhytur në mendime. Në fytyrë sikur dalloheshin të gjitha urtësitë e historisë.

Edhe sikur të mos thoshte asgjë mjaftonte qëndrimi dhe fizionomia për të treguar gjithëçka. Por sulltani dëshirontë të jepte informacione të përshtatshme për kapacitetin e djaloshit. Sulltani filloi të flasë lehtë dhe me një forcë ndikuese:

Bir! Allahu nga një herë robin e gëzon me një mirësi. nga një herë e hidhëron me ndonjë të fatkeqësi. Të dyja këto janë sprova për njeriun. Kur gëzohemi duhet të falenderojmë kur hidhërohemi duhet të durojmë dhe të presim ndihmë prej Allahut.

Jeta është si stinët. Në pranverë dhe vera ka ditë me mot të mirë kurse në vjeshtë dhe dimër ka mot me shi dhe botë.

Sulltanët para meje jetuan pranverën dhe verën e historisë osmane. Kurse unë fatkeqësisht përjetova peridhën e dimrit. Kur u bërë sulltan isha i detyruar të merresha me zgjidhjen e shumë problemëve.

Një kapmion mundje i mund të gjithë por vjen një mikrob i vogël dhe e bën të mos çohet prej krevatit. E njëjta gjë më ndodhi edhe mu. Armiq e mi ishin shumë të vegjël krahasuar me mua por përhapën shumë sëmundje në politikën shtetrore. Gjatë gjithë kohës unë u angazhova të merrem me zgjidhjen problemëve dhe shërimin e këtyre sëmundjeve.

Shkurtimisht unë u përpoqa të pengoja rrënimin e perandorisë. Shumë burra shteti mbetën të mahnitur nga inteligjenca ime politike. Por për shkak të disa burrave të shtetit të cilët nuk më kuptuan u rrënua gjithë ajo perandori.

U përpoqa me të gjihtë mundësitë dhe forcën time për të shpëtuar anijen midis gjitha asaj furtune që kishte shpërthyer midis shtetëve. Por disa njerëz shtetëror mediokër e tërhoqën perandorinë drejt rreziqeve.

Bir! Bëni përpjekje të mos pësoni të njëjtat gabime sepse në këtë mënyrë rrezikon popullin dhe atdheun.

Një nga përvojat që fitova gjatë jetës ishte se shumë njerëz kishin maska. Dikush ishte dhelpër, dikush ujt, dikush hienë,dikush majmun, dikush derr, dikush gjarpër por të gjithë të afroheshin më maskë. Prandaj është shumë e rëndësishme të njihen njerëzit.

Bir! Ne dashurinë për Profetin (a.s) e kemi konsideruar si mirësinë më të madhe. Unë si shprehje e kësaj dashurie bëra rrjetin hekurudhor Stamboll-Medine. Në vendet ku kishte qëndruar Profeti (a.s) bëra stacione treni, në mënyrë që mbanin gjallë kujtimet e Profetit (a.s)

Në këtë moment Sulltanit iu mbushën sytë me lot. Kjo hekurudhë, me gjihtë vështirësitë e madhe që bërballej shteti u ndërtua vetëm me paratë e muslimanëve. Nuk u morë asnjë para nga shtetet e krishtera. Fillimish dhuroj vetë një shumë të madhe duke u bërë në këtë mënyrë shembull për gjithë muslimanët.

Kjo sjellje fisnike ndikoi aq shumë mbi muslimanët sa që u dërguan ndihma nga të gjihtë vendet muslimane, madje edhe nga ato më të varfërat. Shembull i kasaj sjellje ishin muslimanët e Indidë.



Në gjithë vendin ishin hapur pika për mbledhjen e ndihmave për ndërtimin e hekurudhës. Të gjithë njerëzit burra, gra, fëmijë, të moshuar u dyndën për të dhuruar sipas mundësisë që kishin.

Ajo tokë në atë kohë ishte nën sundimin Anglez. Një anglez që i ndiqte me vëmendje zhvillimet transmeton një kujtim të tillë:

Të gjithë sillnin diçka për ta dhuruar.
Në një moment nga turma doli një grua me një foshnjë në dorë që kërkonte të birësonte fëmijën në këmbim të një shume për ta dhuruar për ndërtimin e hekurudhës.

Të gjithë shikonin të habitur me zemër të thyer. Sa e madhe ishte ndjenja e ndihmës kolektive! Më në fund doli një person dhe i dhuroi gruas aq para sa kërkoi dhe ajo i vendosi në vendin e mbledhjes së ndihmave.

Sulltani nuk mundi t'i mbajë lotët, po ashtu edhe Tarih baba me djaloshin nuk mundën t'i mbajnë lotët.

Sulltani tregoi edh për disa shërbime të tjera që i kishte bërë vendit, popullit, shkencës dhe qytetrimit. Pasi theksoi se këto po i tregonte për të marrë shembull jo për t'u mburrur tha:

Unë e kalova jetën jo për të sunduar botën por për të fituar sprovën e botës tjetër. Sepse ata që janë dhënë pas pozitës dhe famës së kësaj botë janë janë poshtëruar. Dielli që hyn nga dritaret

e zbukuruara me ar është i njëjtë me dritën e diellit që hyn nga një dritare me xhama të thyer. Ata që janë përfshirë nga pasuria e përkohshme e kësaj bote kanë përfunduar në fundërrina kurse ata që kanë synuar ahiretin kanë sunduar botën dhe kanë fituar botën tjetër.

Të uroj suskes në rrugën tënde të mirësisë biri im. Pas fjalës së fundit të Sulltan Abdulhamitit, Tarih baba dhe djaloshi u ndanë prej tij me shumë të vërteta me vete.

Vizitë tek Sulltaneshë Behixhe

Djaloshi po mendonte për Sulltan Abdulhamidin. Dëshironte ta njihte pak më shumë. Kur ia parashtroi këtë mendim Tarih Babës, të dy sëbashku shkuan tek bashkëshortja e Abdulhamidit. Kjo grua e cila kishte vuajtur shumë gurbet pasi e larguan nga Turqia, i priti gjithë zemërsi dhe dashamirësi. Kur erdhi fjala tek historia tha:

Sulltan Abdulhamidi ishte shumë i kujdesshëm ndaj haramëve. Namazet nuk i neglizhonte kurrë, gjithmonë e falte namazin në kohën e vet. Në dhomëne gjumint nuk mbante Kuran, aty ku ndodhej Kurani nuk u shtrinte ratë.

Në dhomën e gjumit kishte një tullë të cilën e përdorte për tejemmun në mënyrë që të mos shkonte paabdes deri në abdes'hane.

Çdo ditë lexonte suren Jasin.

Gjatë luftës me Greqinë nuk ka vu gjumë në sy fare. Rrinte gjithë natën deri në mëgjes me harta në dorë. Merrte informacion

në çdo moment dhe vazhdimisht bënte lutje. Ishte shumë i mëshirshëm. Ata që i organziaun atentet thjesht i dënoi me internim por pagën nuk ia ndërpreu.

Sulltaneshë Behixhe tregoi edhe shumë gjëra të tjera në lidhje me të kaluarën. Në fund tha: u copëtuam dhe përçamë. Kur tha këto fjalë të gjithë i përfshiu një mërzitje.

Djaloshi dhe Tarih baba u ndanë prej aty për të shkuar tek vajza e Sulltanit Shadija.

Vizita tek Sulltaneshë Shadija

Emigrimi i kësaj princeshe pati filluar qysh në fëmijëri. Kur u shkarkua në detyra Abdulhamdi filluan ditë të vështira dhe dhimbshme për gjithë familjen. Princeshë Shadija filloi të tregojë për babain Sulltan Abdulhamidin.

Tarih baba i dinte ato por djaloshi po i dëgjonte për herë të parë dhe kishte një mllef të madh që nuk ia kishin mësuar ose më keq akoma ia kishin mësuar gabim.

Priceshë Shadija tha:

Babai ishte shtatlartë dhe i shëndetshëm, ao flinte shumë pak, zgjohej herët dhe punonte shumë. I kuptonte shumë mirë punët e shtetit dhe kishte kënaqësi nga angazhime me punë. I pëlqente të punonte në kolektiv, një pjesë të mirë të ditës e kalonte duke punuar me njerëzit e tij në saraj.

Midis të tjerash princesha përmendi edhe një shembull që tregonte shumë bukur ndjenjën e përgjegjsisë së sulltanit.

Në kohën e babait kujtoj vetëm një luftë, atë me Greqinë. Kjo luftë është zhvilluar në fëmijërinë time. Më kujtohet që në saraj silleshin topa pëlhurash për të qepur rroba për ushtarët. Gjatë gjithë natës deri në mëngjes qepnim rroba për ushtarët. Edhe unë që isha fëmijë kam qepur rroba për ushtarët në luftë. Babai vinte shpesh dhe gjithmonë thoshte:

Ju lumtë bijat e mija, Allahu qoftë i kënaqur me ju. Sa mirë që punoni për atdheun! E ruajtë Allahu atdheun tonë nga armiq. Ne motivoheshim nga këto fjalë. Gjithmonë dëgjonin fjalën atdhe prej babait.

Një pjesë e sarajit ishte shndërruar në spital për ushtarët e plagosur. Babai vinte persontalisht dhe interesohet për ta në mënyrë individuale. Gjithmonë dërgonte ëmbëlsira ose llokume.

Gjithashtu princeshë Shadija tregoi edhe një kujtim tjetër që theksonte fort dashurinë e babait për popullin dhe atdheun:

Kur u shkarkua babai im erdhën për ta takuar ambasadorët e Francës, Anglisë dhe Gjermanisë. Ata i ofruan mundësinë për t'u streguar në vendin e tyre respektiv. Babai pasi i falënderoi dhe u shprehu panevojshmërinë për një gjë të tillë.

Pas takimit e kam dëgjuar me veshët e mi babain të thotë:

Të gjitha përgaditjet ishin bërë për më vrarë edhe mua si xhaxhain tim Abdulazizin. Megjithëse e dija këtë gjë nuk mendova kurrë të strehohem në një vend tjetër të huaj. Largimi nga atdheu është një turp i madh. Sidomos për mua që kam qenë mbi 30 vjet sulltan është një poshtërsi e madhe arratisja nga ardheu. Unë jam i kënaqur me caktimin e Allahut.

Djaloshin e trishtuan shumë veshtirësitë e mëdha që kishte kaluar ky sulltan me këtë moral të lartë dhe me këtë dashuri të madhe për atdheun.

Djaloshi nga njëra anë trishtohej nga ato që po mësonte nga ana tjetër gëzohej. Trishtohem për ngjarjet që kishin ndodhur por gjente qetësi kur mendonte se kishte mësuar të vërtetën dhe kishte mundësi t'ia tregonte edhe shokëve. Sa mirë që ishte me Tarih Babën. Qëndrimi me të i kishte dhënë mundësi të mësonte shumë gjëra.

Tarih baba i tregoi edhe një kujtim tjetër të Sulltan Abdulhamidit, të cilit djaloshi e dëgjoi me vëmendje të madhe.

Lufta e vitit 1897 midis Turqisë dhe Greqisë kishte përfunduar me fitoren e Turqisë, kjo kishte bërë që gjithë bota islame të gëzohej dhe festonte këtë fitore. Por gëzimin e Abdulhamidit e pengonte diçka. Sulltani i kishte sjellë në Stamboll të gjithë të plagosurit, dhe i kishte shpërndarë nëpër spitale për kurim. Gjendjen e tyre e ndiqte personalisht. Sulltani që ishte vetë një marangoz i zoti shkoi urdhëroi gjeneral Mehmetin të bënte 150 bastunë. Gjenerali nga kureshtja pyeti përse duhet gjithë këto bastunë.

Me sa di unë shumica e ushtarëve janë plagosur nga këmbët. Kur të shërohen të gjithë do të kenë nevojë për bastunë. Kur të dalin prej spitali do t'i bëj dhuratë nga një shkop.

Shiko bir çfarë përkujdesje dhe mëshirë! Sulltani përgadit personalishte bastunë për ushtarët.

Pastaj Tarih Baba e dërgoi djaloshin tek dëshmorët e Çanakkalesë për të mësuar më tepër për fitoret e mëdha të popullit.

Vizitë tek dëshmorët e Çanakkalesë

Një nga dëshmorët e Çanakkalesë ashtu i gjakosur u çua dhe tha:

Nipi im! Dëshmorët e Çanakkalesë janë kujtim për çdo shtëpi në Anadol. Varret e këtyre dëshmorëve janë zemrat e popullit.

Edhe ti je një jetim që ne kemi lënë mbrapa. Përpjekja jonë materiale dhe shpirtërore të vazhdojë me ju.

Një dëshmor tjetër tha:

Bir! Kur unë erdha këtu nuk kam lënë pas asnjë kovë grurë, rrobat që kisha veshur ishin të grisura. Por si pasojë e luftës së ndershme notojmë në mirësi pafund.

Ashtu si në Luftën e Bedrit, ushtirsë islame i erdhën në ndihmë engjëjt edhe ne kemi dhënë shpirt në krahë të egjujve.

Bir im! Fuqia i përket Allahut. Sa më shumë t'i bindemi Allahut aq më të fortë bëhemi. Allahu na ka lajmëruar se të gjithë pasuritë e universit i përkasin Atij.

Jeta e vërtetë është jeta tjetër. Por jeta e dunjasë i vesh një tis mjegullë asaj. Pradaj zemra duhet mbajtur e pastër. Ne tani jemi në qetësi dhe parajsë.

Biri im! Dili zot historisë, gjuhës, fesë dhe kulturës tënde. Ata që harrojnë të kaluarën janë të destinuar të përjetojnë përsëri fatkeqësi. Ata që nuk mbrojnë gjuhën nuk mund të mbrojnë kulturën dhe qytetrimin madje as fenë. Ai që nuk di gjuhën e vet nuk mund të mësojë gjuhë tjetër.

Biri im! Kthehu tek rrënjët tuaja. Ji i vetëdijshëm që gjyshërit tuaj më tepër së vende çliruan zemra. Nëse shpata përdoret me zemrën çon në fitore në të kundërt kur përdoret vetëm shpata ajo shkakton vetëm viktima. Ti përpiqu të çlirosh zemra. Përmëtepër që fitorja e shpatës është e përkohshme kurse çlirimi i zemrës është i përjetshëm.

Një dëshmor tjetër tha:

Mësimi që duhet të nxjerrësh prej Çanakkalesë është ky: Nëse në një luftë ka dëshmorë për fe dhe atdhe atëherë një fitore e madhe është afër. Por nëse në një luftë thjesht vdesin njerëz të varfër shpirtërisht pas tyre ka vetëm rrënim.

Një dëshmor tjetër tha:

Çdo fitore arrihet me sakrifica. Sipas rregullave që Allahu ka vendosur në univers çdo synim ka një kosto. Një farë jep rezultat në raport të drejtë me përpjkjen dhe kujdesin që tregon ti për të. Fitoret arrihen me guxim dhe durim të madh, nëse ke guxim dhe durim në këtë botë edhe në botën tjetër arrin fitore. Pra si të jetosh ashtu do të vdesësh. Prandaj jetojeni fenë me entuziazëm.

Nëse jetoni në këtë botë duke dashur dhe bindur Allahut në ditën e gjykimit Allahud do t'ju përfshijë nën hijen e Arshit të Tij.

Një dëshmor tjetër tha:

Bir! Japonezët i tregojnë fëmijëve të tyre vendet ku Amerika ka hedhur bombën atomike dhe i thonë:

Nëse nuk përpiqeni, nëse nuk bëheni të fortë materialisht dhe shpirtërisht do të përballeni përsëri me një fatkeqësi të tillë. Mos e harroni kurrë këtë faktkeqësi. Ecni përpara dhe zhvillohuni duke mos e harruar kurrë këtë.

Edhe ti mos i harro ngjarjet e dhimbshme që kanë kaluar të parët tuaj në Anadoll, Ballkan, Kaukaz, Jemin, Algjeri etj. Lexoji krimet që kanë bërë grekët, armenët dhe rusët. Dhe mbi të gjitha

mos e harro kurrë luftën e Çanakkalesë. Nxirr mësime nga lufta e Bosnjes. Njihe mirë mikun dhe armikun. Përpiqu t'i përdorni dhe shfrytëzoni sa mirë mirë pasuritë nën dhe mbi tokësore.

Kurrë mos e nënvleftëso veten. Një thumb shpëton një patkua, një patkua shpëton një kalë, një kalë shpëton një komandant dhe një komandant shpëton një komb.

Më në fund djaloshi dhe Tarih Baba shkuan për të vizituar nënën e Sejjdi Obashit. Kur shkuan pranë saj ajo tha:

O Bir! Kurrë mos harro, një komb arrinë fitore përmes nënash të ndreshme dhe besimtare. Xheneti është nën këmbët e nënave të tilla. Me nëna të tilla shoqëria jeton e qetë dhe në paqe në të kundërt shoqëria bie preh e veseve sepse çdo fëmijë edukatëne parë e merr prej nënës.

Nëse në një shoqëri ka nëna të ndershme, të besës dhe të sakrificës patjetër që në atë shoqëri do të dalin njerëz të mëdhenjë. Nënat janë heroinat e panjohura të historisë. Në bir jemi fëmijë të nënave që qëndronin gjithmonë me abdest dhe na ushqenin qumësht duke kënduar Jasinin.

Në këtë mënurë është rritur dhe edukuar Sejjidi. Edhe pas luftës së Çanakkalesë ka jetuar i ndershëm. Kaloi shumë vështirësi dhe vuajtje por kurrë nuk hoqi dorë nga morali dhe feja.

Pës kësaj Tarih baba e dërgoi djaloshin në ditët e sotme.

Vizita e ditëve të sotme

Përpara djalit tani qëndronte në gërmadhë, një gërmadhë ku gjuha, kultura dhe historia ishin copëtuar.

Djaloshi pyeti:

Çfarë i ndodhi trimave si luanë që ishin këtu?

Tarih babasë i rrodhën lotë. Pastaj tha:

Biri im! Siç e pe pak më para dikush prej tyre shkoi në Kosovë, në Vjenën, në Çanakkale kurse pjesa tjetër shkuan në luftën çlirimitare. Ata bënë histori me besimin, trimërinë, diturinë, pasurinë dhe jetën e tyre. Kurse si trashgimtarë të lanë ty. Tani të tako ty t'i dalësh për zot trashgimërisë. Mos u bëj pesimist sepse ti je nipi i tyre. Historinë 623-vjeçare plot nder dhe famë të shtetit osman, poeti e përmbledh me këto vargje:

KUSH ISHA?

Po t'i pyesësh shekujt, të tregojnë se kush kam qenë!
Një tjetër det isha, çereku i globit ishte imi!

Plumbat dhe flakët më pandehnin kala,
Rrënojat e kurorave mbretërore fluturonin, dallgëzonin...
Në gjurmën e përgjakur, e përflakur të kalit tim në trok
Një thellësi ishte reflektimi im në detin e përjetësisë.
Përplasej zemra e qiellit në pëllëmbën e hënës së re,
Dridhej fati i tokës në majë të plumbit tim...
Shekujt rridhnin nëpër vijën e vizatuar nga dora ime,
Në tre kontinente gjendeshin gjurmët e kalit tim krenar...
Duke fluturuar mbi atë të përpjetë, të tatëpjetë,
Te sunduesit vrapues më të famshëm të tokës,
Një vështrimi i vetëm imi vetëtimë mirësie qe, bujari,
Ishte dhuratë dyshe imja, klima, dhuratë e imja...
Hanxhar ishte përfytyrimi im, gjithë kombet, milli i tij...
Gjoja globi qe vullneti im i pasionuar, femra,
Nervave të saj i jepja harmoninë e zemrës time,
Formën që desha i jepja, ngjyrën që desha...
Bota e di sa i madh isha, unë s'kam qenë kështu!
Prej gjashtë shekujsh u përgjunja për herë të parë!..

E vërtetë bir që ti u detyrove një herë të nënshtroheshe. Përse? Sepse mungonin njerëzit cilësor dhe njerëzit fetarë. Fatkeqësisht punët kishin ra në dorë të njerzëve papersonalitet.

Kurrë mos harro që një shoqëri e shkatrron mungesa e njerëzve cilësor. Perandoria osmane në fillim udhëhiqej nga njerëz cilësor të cilët e çuan përpara perandorinë kurse në periudhën e fundit ra në dorë të njerëzve papersonalitet të cilët e fundosën gjithë atë perandori. Për shkak të mungesës së njerëve cilësor minirstria e mjedisit kishte rënë në duart e një greku. Tregita kishte rënë në

duart e një grupi dashakeqës. Nëse nuk i arsimoni dhe edukoni ju njerëzit atëherë do të përgadisin të huajt. Këta të huaj kultivojnë tek ata vlera të tjera, në këtë mënyrë botë e mbrendshme e tyre është e huaj thjesht nga jasht duken si ne.

Kjo ngjarje është shumë mbresëlënëse:

Fatkeqësitë filluan ta ndjekin njëra-tjetrën. Më 1911, italianët sulmuan Libinë, një tokë e vjetër osmane. Kryeministri tradhtar i organizatës Bashkim e Përparim, Ibrahim Haki Pasha e kishte shndërruar atë vend pothuajse në gjendje të gatshme për t'u pushtuar. Ushtrinë e atjeshme e kishte evakuar në Jemen, kurse valiun dhe komandantin ushtarak i kishte thirrur, me një farë preteksti, në Stamboll. Vetë ai ishte ngjitur në postin e kryeministrit nga ambasador në Itali, prandaj duhet t'i dinte më mirë nga të gjithë qëllimet e italianëve! Përveç të gjitha këtyre, kur i erdhi ultimatumi i qeverisë italiane mbi zbarkimin në Libi, ai ishte duke luajtur brixh me këshilltarin ushtarak në ushtrinë osmane, personin me origjinë italiane, të quajtur Robilan. Kur deshin t'ia jepnin në dorë ultimatumin, u tha ta linin aty mënjanë sa ta mbaronin lojën, dhe e hapi vetëm disa orë më vonë duke treguar një indiferentizëm dhe tradhti të padëgjuar!

Si pasojë e këtyre tradhtive filloi rënia dhe rrënimi i perandorisë. Një komb i mahnitshëm u shkërmoq plotësisht.

Tarih Baba i kujtoi djaloshit veçanërisht fuqinë e historike të trashëguar që zotëronte në mënyrë që të mos humbte besimin dhe biente në pesimizëm. Për t'i forcuar dhe fuqizuar strukturën shpirtërore theksoi këtë:

Ti je një komb i madh

Bir! Çështja që duhet të bësh më shumë kujdes është të nxjerrësh mësime prej historisë dhe të tejkalosh egon dhe të mos biesh në kurthet e saj. Zemrën ta bësh fole dashurie për Allahun, Profetin (a.s)dhe kombin. Kujdes mos e shkatrro zemrën duke u dhënë pas kënaqësive të përkohshme të kësaj bote.

Bir! Kombet jetojnë me besimin, historinë dhe gjuhën. Kombi është kombe me këto tri elementë. Kur ne e kishim ndërtuar çdo gjë mbi këto ideale ne ishim të zotrinjtë e botës.

Bota ishte një ring, Evropa një hipodrom. Të parët tanë kanë marrë nga historia shumë fitore dhe medalje të gjithë këto të mjaftojnë ty si trashëgimëri.

Bir! Mos e harro kurrë këtë:

Për sa kohë do të ketë Alpasrlan që vishte rroba të bardha duke thënë ky ësthë qefini im, dhe dilte para ushtrisë armike duke luftuar heroikisht.

Për sa kohë do të ketë njerëz si Mevlana të cilët zemrat i kanë pasur strehë dhe burim urtësie.

Për sa kohë do të ketë Osman Gazi i cili sakrifikoi në rrugën e Allahut,

Për sa kohë do të ketë Murat Han i cili thoshte dua të bie dëshmor në këtë luftë.

Përsa kohë do të ketë Fatih i cili dilte para gjygjit si një individ i thjeshtë, ti do të jesh gjithmonë një komb i madh.



Nëse nxjerr dijetar që i thotë drejtuesit detyra ime është të shpëtoj në botën e përtejme duke e detyruar drejtuesin të heqë dorë nga vendimi i gabuar ti do të jesh një komb i madh si në të kaluarën.

Nëse do të kesh personalitete prej të cilëve popujt që kanë pasur nën sundim kanë qenë më të kënaqur me ta se sa me udhëheqësit vendas dhe ti ke krijuar një sistem drejtësie të përsosur ti je një komb i madh.

Nëse do të keni Ulubatlë Hasanë të cilët gjatë çdlirimit të Stambollit hidheshin para flakëve dhe llavës përvëluese që lëshohej nga lart duke thënë: është rradha jonë për të rënë dëshmor atëherë ti je komb i madh.

Nëse do të kesh Sulejmanë që mendojnë edhe për të drejtën e një milingone, nëse do të keshë personalitete si Abdulhamidit i cili u paralizua nga keqardhja për rënien e kalasë së Ozit.

Nëse do të kesh personalitete si Fuzuli të mbushur me dashurinë për Profetin (a.s),

Nëse do të ketë nëna të cilat e kanë zemrën të mbushur me Kuran dhe rritin fëmijë të hajrit,

Nëse bota është e vogël në syrin tënd dhe ideali jot është lumturia në botën tjetër atëherë ti je një komb i madh.

Mos u trishto! Shpirti kombëtar i cili mbrojti Anadollin është gjallë. Kurrë mos bjerë në pesimizëm përballë ngjarjeve. Besimtari është gjithmonë optimist. Ai strehohet tek Allahu dhe kërkon ndihmë prej Tij. Sepse humbja e shpresës nga Allahu është haram.

Nëse ezani që këndohet dhe lartësohet në qiell të jep shpirtshmëri në zemër, nëse flamuri që valëvitet të jep fuqi atëre ti je një trashgimëtar i denjë i amanetëve të shenjta.

Ndërsa Tarih Baba por tregonte këto, nga minaret e xhamisë Sulejmanije ezani i Sabahut i dha fund ëndërrë së djaloshit. Por mendimet e tij ishin shumë të kthjellta tashmë. Duke menduar se si do të kalojë kjo ditë e re tha me vete:

Ky mëngjes sikur ishte një mëngjes krejt ndryshe nga të tjerët. U kthye nga Kibla hapi duar dhe nga thellësia e zemrës i rrodhën këto fjalë:

O Zot im! Ashtu si pas një natë të errët vjen agimi plot dritë ashtu jepi këtij populli dritë dhe zhvillim në të ardhmen.

Amin!..